



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600164/5

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandohet marrja e nismës për ndryshim në legjislacion*

Drejtuar : **Ylli Manjani**
Ministër i Drejtësisë

TIRANE

I nderuar Z. Ministër!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në procesin e shqyrtimit të ankesave të depozituara nga shtetas të ndryshëm, ka konstatuar se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, ka kryer veprime përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, duke vendosur masën e sekuestrës dhe mbi të ardhurat mujore të përfituara nga pala debitorë si ndihmë për trajtimin shëndetësor të tyre.

Kryerja e kësaj veprimtarie prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, nuk është se vjen në kundërshtim me parashikimet e ndonjë dispozite konkrete ligjore, dhe aq më tepër me parashikimet e nenit 529/6 "Sendet mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestroja" të Kodit të Procedurës Civile, i cili përjashton nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit ;

"ndihmat që u jepen nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa se studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës".

Institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetas L.A, ka konstatuar, se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Privat, Përmbaruesja Gjyqësore Private Jordisa Dervishi, ka vendosur masën e sekuestrës mbi të ardhurat e përfituar si ndihmë për trajtimin shëndetësor të debitorit, të cilat jepen në favor të tij prej Spitalit Rajonal, Fier, në mënyrë të përmuajshme, konform legjislacionit në fuqi.

Qëllimi për të cilin jepet ndihma e përmuajshme në të holla (4.200 lekë) debitorit A.A, prej Spitalit Rajonal, Fier, është mundësimi i transportit të tij, nga banesa në Spital çdo dy ditë, për marrjen e shërbimit mjekësor, shërbim i cili siguron mbijetesën e debitorit.

Kryerja e veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv mbi të ardhurat e përnuajshme që i disbursohen debitorit për mundësimin e marrjes së trajtimit shëndetësor, vlerësohet nga ana jonë, jo humane dhe në mospërputhje me nenin 21 të Kushtetutës, si dhe nenin 2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të cilat sanksionojnë mbrojtjen e jetës, në të cilët sanksionohet respektivisht:

“Jeta e personit mbrohet me ligj”,

“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Vdekja nuk mund t’i shkaktohet me qëllim askujt me përjashtim të rastit të zbatimit të një vendimi kapital të dhënë nga një gjykatë kur krimi ndëshkohet nga ligji me këtë dënim”.

Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë, kuptohet se, nuk vjen në përputhje me parimet e lartpërmendura në rastin e vendosjes së masës të sekuestrës mbi të ardhurat e debitorit të siguruara si ndihmë shtetërore për trajtimin shëndetësor të tij.

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të detyrës së tij, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, mbështetur në parashikimet e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe parashikimet e nenit 24 të Ligjit nr. 8454, date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkaku që krijon premisë për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë : a) t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin e përmirësimin e ligjeve....;”,

REKOMANDOJMË

“Marrjen e nismës për ndryshimin e dispozitës ligjore, neni 529/6 të Kodit të Procedurës Civile, duke përfshirë në të dhe ndihmën që jepet për trajtimin shëndetësor si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestrës.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenin 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të mundësohet bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**